


MASKA

*Revista Elektronike
Radio e RII në gj. shqipe
Nr.2, nëntor, viti 2016.*



Filozofia për vrasjen e personave me veprime terroriste dhe për krijimin e ndryshimeve shoqërore nëpërmjet terrorizmit, është formuar në gjysmën e dytë të shekullit 19 duke filluar një periudhë e re në formimin e grupeve terroriste.

Shumë lëvizje që besonin në këtë linjë arsyetonin veprimet e tyre të dhunshme duke shfrytëzuar popullarizmin, kërkesën për pavarësi dhe mosdurimin e status kohës që në atë kohë përbënte karakteristikën më të dalluar të zhvillimeve shoqërore. Me formimin e lëvizjes Karaboner në Itali, të

njeriut në kuadër të individualizmit të tij duke i dhënë prioritet shoqërisë për t'i shkelur karakteristikat individuale të njeriut në një atmosferë fanatike dhe irracionale, janë veprime që përbëjnë një trashëgimi të cilën grupet e tilla e kanë lënë për pasardhësit e tyre. Ide të tilla emocionuese dhe euforike në fund të shekullit 19 dhe në fillim të shekullit 20, krijuan rrethanat e përshtatshme për daljen në skenë të atentatorëve që kërkonin kaos. Në Evropën Perëndimore kjo ide propagandohej nga anarkistët të cilët rrugën më të mirë për ndryshime politiko-shoqërore e konsideronin shfrytëzimin e metodave revolucionare për vrasjen e personave të cilët kishin uzurpuar funksionet e pushtetit politik. Në këtë mënyrë gjatë 20 viteve nga vitit 1880 deri në vitin 1900, janë vrarë një numër i madh i funksionarëve qeveritarë dhe shtetërorë në Evropë dhe



Borshen Shaft në Gjermanisë, Jugo-Slav në Serbi dhe Narodnaja Velia në Rusi etj., mekanizmi i veprimit të grupeve terroriste u bë më i komplikuar dhe anoi drejt veprimeve sa më të dhunshme dhe u përhap metoda për arritjen e qëllimeve politike duke përdorur armët. Formimi i gjykatave revolucionare dhe lëshimi i dënimeve me vdekje për kundërshtarët politik, mbyllja e syve përballë vrasjes së personave të pafajshëm, gjykimi dhe vrasja e tradhtarëve, si dhe më e rëndësishme nga të gjitha këto, anashkalimi i

Amerikë, prandaj këtë periudhë e kanë emëruar "Epoka e atentateve". Për fat të keq rezultati i shëmtuar i kësaj qasje ishte ai që në qershor të vitit 1914, Francis Ferdinand, trashëgimtari i fronit mbretëror të Austro-Hungarisë u vra nga Gavrilo Princip, një i ri fanatik serb dhe anëtar i lëvizjes studentore "Jugo-Slav" dhe u ndez zjarri i Luftës së Parë Botërore. Në Spanjë, terrorizmi anarkist u bë burim i shpërthimit të luftimeve vdekjeprurëse mes krahut të majtë që besonte në luftën e armatosur dhe pastaj u zgjerua

edhe në rajonin Bask i cili kishte karakteristikë separatiste duke u përhapur edhe në Argjentinë. Në Evropë, gjithashtu kroatët në Jugosllavi, lëvizjet fashiste të ushtrisë së lirë të Gjermanisë dhe Garda e Hekurt në Rumani kanë ndjekur këtë ide se me gjakderdhje të egra mund të bëhen ndryshime shoqërore. Në Lindje e Mesme dhe në Azi në vitin 1930 e më pas, veprimtaria më e madhe terroriste është zhvilluar në Palestinë gjatë periudhës së protektoratit të Anglisë mbi këtë vend ku dy grupe Stern Gang (LEHI) dhe Irgun Zvai Leumi filluan aktivitetin e tyre terrorist. Këto dy grupe edhe pse u shuan pas formimit të qeverisë izraelite, mirëpo liderët e tyre ishin shembuj të atyre të cilët kanë arritur në pushtet me veprime terroriste dhe kriminale. Monakhm Begin, lideri i grupit terrorist Irgun Zvai Leumi dhe Isak Shamir, një prej liderëve të grupit Stern Gang (LEHI), arritën deri në postin e kryeministrit të regjimit sionist.

Në Iran edhe pse rrënjët e terrorit duhet kërkuar në veprimtarinë e sektit Ismailije të udhëhequr nga Hasan Sabah, mirëpo në periudhën bashkëkohore ideja e luftës së armatosur dhe shfrytëzimi i terrorizmit për ndryshimin e pushtetit politik, ishte një ide e cila ka hyrë në Iran nëpërmjet revolucionarëve kaukazianë pas revolucionit të Rusisë dhe gjatë periudhës së revolucionit për Kushtetutë në Iran. Në prag të revolucionit për Kushtetutë rreth 1000 persona nga anëtarët e partisë social-

demokrate të Kaukazit si Hejdarkhan Amuoglu dhe Japram Khan hyjnë në Iran dhe përhapën veprimet gangstere! Në fillim të periudhës së revolucionit të Kushtetutës, shpërthimet me bomba dhe vrasjet terroriste ose atentatet arritën kulmin e tyre dhe si pasojë u vranë shumë klerikë fetarë dhe deputetë të Parlamentit. Edhe anëtarët e partisë popullore komuniste që në Iran quhej partia "Tude", kanë shfrytëzuar terrorin dhe prej veprimeve më të këqija të tyre ishte vrasja e Muhamed Mas'ud, drejtor i gazetës "Marde Emruz" dhe vrasja e Ahmed Dehkan Kermani, drejtor i revistës "Teherane Mosaver". Guerilët flijues hartuan modelin persian të një ideje e cila ishte krijuar për shkak të luftërave të mëdha guerile në Kinë dhe në Kubë. Kjo ide shkante edhe më larg se terrorizmi qytetar dhe qytetin e konsideronte varrezë të luftëtarëve revolucionarë, ndërsa terrorin e pranonte vetëm si plotësues të luftës feudale. Flijuesit "Fadaijan" veprimtarinë e tyre e kishin filluar nga qyteti Sejahkal. Më pas dolën në skenë pjesëtarët e grupit Moxhahedine Khalk të cilët përsëri ringjallën terrorizmin qytetar në teori dhe veprim duke paraqitur në skenën shoqërore trashëgiminë e paraardhësve të tyre ideologjik në vazhdimin e terrorizmit anarkist dhe duke ndjekur ndryshimet shoqërore nëpërmjet terrorizmit. Grupi Fadaijan i quante pjesëtarët e grupit Moxhahedine Khalk "marksistë të turpëruar".



Shpallja e ndryshimit të ideologjisë

Në orën 1:30 të natës së 5 Prillit 1974, ndodhi një ngjarje vendimtare në historinë e organizatës Muxhahedin-e-Khalk. Teki Shahram, njëri prej anëtarëve të burgosur të organizatës, së bashku me Husein Izeti Komrei, i burgosur anëtar i grupit marksist Ylli i Kuq dhe me Amir Husein Ahmedian Cashmi, gardian i burgut në qytetin Sari, i cili ishte tërhequr nga fjalët e Teki Shahram, u arratisën nga burgu i sapondërtuar dhe modern në Sari. Teki Shahram ishte arrestuar në Shtator 1972 dhe ishte dënuar me 10 vjet burgim.

Ai vinte nga një familje e pasur dhe jofetare. Ai ishte njohur në universitet me Ali Reza Zomorodian dhe me Muhamed Hajati dhe nën ndikimin e tyre u pri drejt fesë dhe rezistencës. Teki Shahram para se të


anëtarësohej në organizatë, kishte lidhje me njërin nga anëtarët e grupit Partizanët e Popullit. Në burgun Ghasr në Teheran, Shahram u njoh me Afshani, një prej të dënuarve të grupit Partizanët e Popullit dhe me Ali Reza Shokuhi, kryetar i grupit Ylli i Kuq si dhe me Husein Izeti, një prej atëtarëve të këtij grupi dhe pranë tyre plotësoi dijet e tij marksiste. Disa nga anëtarët e vjetër të organizatës thonë se afrimi i Shahram me Husein Izeti ishte një kurth i Savak-ut (Shërbimi sekret e regjimit të Shahut) për të mësuar sekretet e të burgosurve. Në burg, Shahram i ndiqte të gjitha çështjet, u njoh me shumë persona dhe arriti në nivelet më të

larta të organizatës. Në kohën kur Shahram u arratis nga burgu, organizata ishte nën goditjet e fuqishme të Savak-ut dhe kryesinë e organizatës e kishte Reza Rezai. Disa kohë pas arratisjes, Reza Rezai ishte duke ngrënë darkë në banesën e njërit pres simpatizantëve të organizatës kur në derë trokitën agjentët e Savak-ut. Rezai me shpejtësi u ngjit në tarracë dhe prej andej u hodh në një rrugicë dhe u fsheh nën një makinë, por duke menduar se agjentët e kishin pikasur, vret

veten me plumb në kokë. Pas Reza Rezai, organizata kishte tre degë, politike, ushtarake dhe punëtore, të cilat kryesoheshin respektivisht nga Teki Shahram, Behram Aram dhe Mexhid Sharif Vakefi. Teki Shahram, me ndihmën e Behram Aram, u


përpoq të shtrinte kontrollin e tij mbi të gjithë organizatën dhe të pengonte përcarjen ideologjike të organizatës. Në këtë rrugë, pas likuidimit fizik të Sharif Vakefi dhe të Samedije Leba,

komiteti qendror i organizatës, e cila zyrtarisht ishte bërë marksiste, programoi planet për ndryshimin ideologjik edhe të anëtarëve të tjerë. Tashmë lidhshipi i organizatës kishte rënë në dorën e një personi që ishte Teki Shahram, ndërsa kuadrot e tjerë të organizatës ishin bërë vegla të bindura të tij. Shahram konsideronte se misioni i tij më i rëndësishëm ishte kthimi i të gjithë anëtarëve në marksistë. Ai fillimisht zgjodhi njërin nga kuadrot e rëndësishëm të organizatës i quajtur Naser Xhohari dhe së bashku filluan të programonin lënien mënjane të ideologjive të tjera dhe zgjedhjen e ideologjisë marksiste si të vetmen ideologji të organizatës. Ky plan




kishte për qëllim punën psikologjike dhe përgatitjen shpirtërore të anëtarëve për të braktisur fenë, për ndaljen e mësimave fetare dhe për zëvendësimin e tyre me mësimet marksiste. Duke pasur parasysh bindjen e verbër të anëtarëve në sistemin e “centralizmit demokratik”, kthimi i tyre në marksistë nuk ishte shumë i vështirë. Halil Dezfuli, një nga anëtarët e organizatës që varej nga Naser Xhohari, në lidhje me këtë thotë: “Gjithmonë isha absolutisht i bindur ndaj eprorëve dhe i konsideroja ata si njerëz shumë të përgatitur e të pagabueshëm. Cështjen e ideologjisë e kisha diskutuar më parë edhe me shokët e klasës dhe ata e kishin pranuar marksizmin si ideologjinë e tyre. Pra, u bëmë marksistë.” Ali Khodaisefat, tjetër anëtar i organizatës, duke cituar Behram Aram, e përcjell kështu këtë proces: “Ideologjia e organizatës ishte e përzier, kishte baza materialiste dhe i kishin ngjitur

gjithë anëtarët muslimanë të organizatës dhe i dha Savak-ut të gjitha informatat mbi organizatën, anëtarët, përkrahësit dhe operacionet që ishin kryer. Ai arriti deri atje, sa që morri pjesë së bashku me agjentët e Savak-ut në hetimin dhe torturimin e anëtarëve të arrestuar. Duke shprehur largimin nga rezistenca, duke lartësuar regjimin e Shahut dhe duke bashkëpunuar plotësisht me Savak-un, Vahid Afrakhte u shndërrua në një nga torturuesit më të mirë të regjimit. Ai në një letër drejtuar Manucehrit, torturuesit të famshëm të Savak-ut, e tregon kështu procesin hetimor ndaj Samedije Lebaf: “ Zoti doktor Manucehri, përshëndetje. Debatova mjaftueshëm me Murteza Samedije Lebaf... Mendoj se ende nuk i ka dhënë të gjitha informatat... Nëse nuk pranon të flasë me të mira, duhet përdorur presioni (tortura).” Meqë Vahid Afrakhte kishte marrë pjesë në vrasjen e këshilltarëve




Samedije Lebaf



Vahid Afrakhte



Mexhid Sharif Vakefi



Teki Shahram

një sfond fetar. Kjo gjë nuk shkonte sepse, dialektika është themeli i materializmit.” Në procesin e rrënjosjes së marksizmit, deri në vjeshtën e vitit 1975, të paktën 90 kuadro dhe anëtarë të lartë të organizatës brenda dhe jashtë Iranit, kishin pranuar zyrtarisht marksizmit si ideologji të tyre. Kjo shkaktoi irritimin e klerikëve që kishin lidhje me organizatën si dhe ndërprerjen e ndihmave të popullit, sepse deri atëhere, ata kishin menduar se kjo është një organizatë fetare dhe shumë klerikë dhe tregtarë të mëdhenj kishin dhënë ndihma të shumta financiare për mbijetesën e organizatës. Në këtë kohë, Vahid Afrakhte, anëtar qendror dhe marksist i organizatës, u zbulua dhe u arrestua nga një agjent i Savak-ut në rrugën Beharestan në Teheran. Që në fillim të hetimit, ai zbuloi të

ushtarakë amerikanë dhe ky fakt ishte përmendur edhe nga mediat në lajmin e arrestimit të tij, megjithë bashkëpunimin e ngushtë me Savak-un, ai nuk mundi të shpëtojë dhe u ekzekutua në Shkurtin e vitit 1975. As në castin e fundit atij nuk i besohej që do të ekzekutohej dhe në testamentin e shkruajtur disa minuta para ekzekutimit, shkruante: “ Duke dashur që deri në castin e fundit të jetës time të bashkëpunoj me organin e sigurisë dhe të vdes si një ushtar besnik dhe i devotshëm për Shahun tim të dashur, dua që të takoj një funksionar të lartë të sigurisë, i cili më njeh, dhe t’i them disa fjalë.” Sigurisht, Afrakhte nuk realizoi asnjë nga këto dëshira dhe u ekzekutua disa caste pasi shkroi këto fjalë. Pas arrestimeve masive që ndodhën si pasojë e tradhtisë së Vahid

Afrakhte, komiteti qendror i organizatës në Maj 1975 publikoi një komunikatë me titull “Shpallja e qëndrimeve ideologjike”. Me arrestimin e Vahid Afrakhte, Savak-u e kishte kuptuar se organizata kishte marrë ideologji marksiste dhe ishte vënë në dijeni të likuidimeve të kundërshtarëve të kësaj ideologjie brenda organizatës dhe ky fakt nuk ishte me i fshehtë për askënd. Si rrjedhim, komiteti qendror i organizatës u detyrua të sqarojë me shpejtësi dhe zyrtarisht vendimet e tij. Në këtë komunikatë, shpjegoheshin arsyet e lënies mënjane të Islamit dhe pranimi të marksizmit, ndërsa likuidimet fizike brenda organizatës u cilësuan si një proces normal i zhdukjes së tradhtarëve. Një veprim i tillë që konfirmoi pretendimet e regjimit të Shahut se kundërshtarët e tij kanë ideologji marksisto-islame, dhe në kushtet kur regjimi edhe studentët e shkollave teologjike i quante marksistë, ishte një goditje e rëndë për rezistencën islamike të popullit iranian. Publikimi i komunikatës me titull “Shpallja e qëndrimeve ideologjike” pati reagime të fuqishme dhe të ndryshme në qarqet sociale dhe të rezistencës në Iran e në vecanti në mesin e muslimanëve të cilët me mirëbesim dhe optimizëm e kishin përkrahur këtë organizatë. Megjithatë, kjo u bë shkak që të rinjtë dhe studentët të afroheshin më shumë me qarqet fetare dhe me mësuesit e mëdhenj si profesori dëshmor Motahari. Qarqet muslimane të rezistencës, pasi e kuptuan se krerët dhe anëtarët e organizatës nuk kishin asnjë lidhje me besimin dhe principet islame, por vetëm kishin luajtur me ndjenjat e muslimanëve, i quajtën ata “munafikë” (hipokritë).

Pasi Teki Shahram mori kontrollin e plotë të organizatës, ai vendosi rregulla të forta për ruajtjen e tij. Ditë e natë atë e ruanin dy femra që shërbenin si eskorta e tij. Simin Taxh Hariri, Lejla Zomorodian, Fatime Mirza Xhafer Alaf dhe Mahbube Motahedin ishin nga ato femra që i shërbenin këtij njeriu të cuditshëm dhe që më pas, ose në mënyrë të dyshimtë u kapën nga Savak-u, ose pësuan trauma psikike, ose u vetëvranë. Këto ngjarje si dhe kritikën e disa anëtarëve të komitetit qendror, të cilët kishin frikë nga urdhërat e

Teki Shahram për likuidimin e anëtarëve të organizatës, u bënë shkak që të dobësohej lidhshipti i Shahram. Më në fund, ai u largua nga komiteti qendror dhe u largua jashtë vendit. Nga Shtatori i vitit 1976, ai jetoi në Londër. Pas fitores së revolucionit islamik, ai u kthye në Iran ku u identifikua nga luftëtarët muslimanë, u arrestua dhe pasi u gjykua në Gjykatën Revolucionare, u ekzekutua. Nga fundi i vitit 1977, nga kjo organizatë nuk kishin mbetur tjetër, vecse disa forca të shpërndara dhe tashmë organizata ishte përfshirë nga mosmarrëveshjet, nga largimi i kuadrove jashtë vendit dhe nga pasiviteti i anëtarëve brenda vendit.


Riorganizimi i organizatës në burg

Pas shpalljes së ndryshimit të ideologjisë, disa nga anëtarët e mbetur në burgje filluan të riorganizojnë organizatën me ideologjinë mikse. Shumica e këtyre personave u mblodhën rreth një njeriu të quajtur Masud Raxhavi. Ai ishte i vetmi anëtar i komitetit të parë qendror që kishte mbetur gjallë dhe ishte arrestuar në valën e parë të arrestimeve në vitin 1972. Në kohën e arrestimit, raxhavi ishte më i riu mes anëtarëve të komitetit qendror të organizatës. Pas goditjes së Shtatorit 1972, Hanifnezhad e kishte futur atë në komitetin qendror. Sic shprehet Masud Hakgu, anëtar i vjetër i organizatës, Hanifnezhad dhe anëtarët e tjerë të komitetit qendror ishin tërhequr shumë nga mënyra e të folurit të Masud Raxhavi. Raxhavi kishte marrë mësim ushtarak në kampet e Fatahut në Jordani. Që në atë kohë, të gjithë e njihnin pikëpamjen e tij ndaj fesë islame. Doktor Kerim Rastegar, anëtar i vjetër i organizatës, transmeton se kur njëri nga anëtarët e Fatahut e kishte pyetur Raxhaviun se cilën do të preferojë nëse lind kontradiktë mes rezistencës dhe fesë, Raxhavi ishte përgjigjur: “Sido që të jetë, ne do të vazhdojmë rezistencën.” Disa të burgosur të asaj kohe, janë të mendimit se në burg Raxhavi e ndryshoi ideologjinë e tij dhe ishte bërë marksist, por këtë nuk e publikoi me qëllim që të ruante pozitën e tij. Raxhavi ishte i vetmi anëtar i komitetit qendror që i shpëtoi ekzekutimit. Meqë ky fakt ishte tepër i dyshimtë, që në atë kohë Raxhavi dhe


përkrahësit e tij sajuan një histori sikur vëllai i tij Kazem Raxhavi, i cili jetonte në Zvicër dhe kishte lidhje me organizatat e të drejtave të njeriut, ka ndërhyrë dhe ka mundur t'a shpëtojë Masud Raxhaviun. Por në bazë të dokumentave të mbetura nga Savaku, e vërteta është ndryshe. E vërteta ishte se Raxhavi, që në fillim të arrestimit kishte filluar bashkëpunimin me Savak-un dhe i kishte dhënë të gjitha informatat që kishte. Sipas dokumentave të Savak-ut, kolonel Nemetullah Nasiri, shefi i Savak-ut, në një letër drejtuar prokurorisë ushtarake e prezanton Masud Raxhaviun si “bashkëpunëtor të Savak-ut”, i cili “gjatë hetimeve ka bashkëpunuar plotësisht në kapjen e anëtarëve të organizatës dhe ka dhënë informacione tepër të vlefshme për ndricimin e gjendjes dhe qëllimeve të kësaj organizate famëkeqe”. Nasiri në vazhdim të letrës, shkruan: “Masud Raxhavi, edhe pas përfundimit të hetimeve ka bashkëpunuar sinqerisht me agjentët e Savak-ut brenda burgjeve, prandaj nga pikëpamja e Savak-ut, ai meriton të shpërblehet dhe t'i ulet dënimi.” Edhe gazeta Kayhan, duke publikuar lajmin mbi ekzekutimin e katër anëtarëve të organizatës, në lidhje me Masud Raxhavi shkruan se “ për shkak se gjatë hetimeve si dhe në burg ka bashkëpunuar maksimalisht me agjentët e sigurisë, me urdhërin e bekuar të Shahut, ekzekutimi i tij është kthyer në burgim.”

Një person i tillë arriti të marrë lidhësin e

të burgosurve të organizatës Muxhahedin-e-Khalk. Ai me dinakërinë dhe hipokrizinë që e karakterizon, ishte marksist me marksistët dhe musliman me muslimanët. Ai i këshillonte anëtarët marksistë të organizatës që të mos e shpallnin veten si marksistë, të falnin namaz, madje i vinte ata në krye të namazit. Pas shpërbërjes së kësaj organizate, emri i organizatës Muxhahedin-e-Khalk u përmend rishtazi pas fitores së revolucionit islamik. Masud Raxhavi dhe bashkëpunëtorët e tij, me zgjuarsin dhe shpejtësinë e mblodhën anëtarët e shpërndarë të organizatës dhe rithemeluan “Organizatën Muxhahedin-e-Khalk Iran.” Në ditët e trazuara në fillim të fitores së revolucionit islamik, veprimi i parë i organizatës ishte pushtimi i Fondacionit Pahlavi në rrugën Valie Asr (ku sot ndodhet Ministria e Tregtisë e Iranit), krijimi i shtëpive gjysmë të fshehta ose të fshehta në mbarë vendin dhe mbledhja e armatimeve dhe municioneve. Gjithashtu u bënë përpjekje të gjera për rekrutimin e anëtarëve të rinj sidomos nga radhët e të rinjve dhe adoleshentëve. Duhet theksuar fakti se shumica e popullit në atë kohë nuk ishte në dijeni të ideologjisë mikse dhe hipokrite të kësaj organizate dhe i konsideronin anëtarët e saj si njerëz të pastër, muslimanë të mashtruar nga komploti i komunistëve. Organizata duke bërë propagandë të gjerë mbi figura si Sharif Vakefi, Murteza Samedije Lebafe dhe Murteza Lebafezhad përpiquej të tërhiqte shtresat muslimane dhe kundërshtarët e marksizmit, por njëkohësisht nuk pranonte të dënonte marksistët që kishin kryer krime ndaj këtyre personave. Organizata e re nuk i njihte si marksistë persona të tillë si Teki Shahram, Behram Aram, Vahid Afrakhte e të tjerët si ata. Këtyre personave u ngjiti damkën “oportunistë majtistë” dhe në këtë mënyrë u përpoq të ruante prestigjin përballë grupeve të tjera dhe personave marksiste, ndërsa nuk dënonte marksizmin dhe marksistët që ishin implikuar në këto komplete.



Në këtë mes gazeta "Moxhahed" u shndërrua në një tribunë për të sulmuar Imam Khomeinin (ra) dhe forcat e linjës së tij. Organizata Moxhahedine Khalk publikonte njoftime dhe deklarata njëra pas tjetrës dhe përdorte çdo masë dhe çdo mjet vetëm e vetëm për ta ndaluar procesin e rrëzimit të presidentit Beni Sadr. Moxhahedine Khalk për këtë arsye lëshoi tre deklarata të njëpasnjëshme më 16 dhe 17 qershor të vitit 1981. Në një pjesë të deklaratës së dytë thuhet: "Në prag të zbatimit të fazës së fundit të grusht shtetit... organizata... propozon që ...



Atentati i pasuksesshëm i grupit terrorist MEK ndaj Ajetullah Khamenei 26 qershor 1981.

populli heroik ... edhe një herë të thërras "All-llahu Akbar" mbi çatitë e shtëpive për të kundërshtuar metodat monopoliste anti-popullore dhe anti-islame, si dhe për të mbështetur liritë themelore dhe presidentin Dr. Beni Sadr!".

Ditën e premte më 18/6/1981, ligjëruesi i namazit të së premtes në Teheran Ajetullah Khamenei në meny të gjerë dhe të plotë, shpjegoi arsyet e rënies së Beni Sadr.

Organizata Moxhahedine Khalk duke mbështetur Beni Sadr, me anë të një njoftimi kërcënues, paralajmëroi deputetët e Parlamentit që të mos marrin pjesë në seancën për shqyrtimin e meritave dhe

kompetencave të presidentit Beni Sadr. Organizata Moxhahedine Khalk gjithashtu

deklaroi se aktiviteti i kësaj organizate ka hyrë në fazën ushtarake. Nga data 19 qershor 1981, filloi vala e gjerë e terrorit dhe vrasjes nga ana e Organizatës Moxhahedine Khalk deri në atë masë sa që përfshijë të gjithë qytetarët nga populli i thjeshtë në rrugë e deri tek funksionarët shtetërorë të vendit.

Të shtunën pasdite më 19 qershor 1981, në kohën kur Parlamenti i Iranit ishte duke shqyrtuar heqjen e kompetencave të Beni Sadr, përkrahësit e Organizatës Moxhahedine Khalk në Teheran dhe në disa qytete të tjera

të mëdha të Iranit, filluan disa veprime të cilat nuk kishin rezultat tjetër përveç dështimit të tyre. Përkrahësit e Organizatës Moxhahedine Khalk dhe të disa grupeve më të vogla të cilat ishin mbledhur në përkrahje të presidentit Beni Sadr dhe sipas tyre ishin futur në "fazën ushtarake", me armë të ftohta dhe armë zjarri filluan trazirat në rrugët qendrore të Teheranit duke vrarë dhe plagosur me dhjetëra qytetarë të pafajshëm dhe duke dëmtuar pronat publike. Këto grupe në këtë mënyrë shënuan "të shtunën e përgjakshme" në historinë e Iranit. Organizata Moxhahedine Khalk më pas, datën 19 qershor 1981 e ka paraqitur si një kthesë të madhe në historinë e Iranit dhe pretendoi se në protestat e 19 qershorit 1981 kanë marrë pjesë 500 mijë qytetarë. Kjo është në kohën kur numri i personave të organizuar nga Organizata Moxhahedine Khalk dhe nga grupet e tjera që iu bashkuan asaj në mbështetje të Beni Sadr me protesta të dhunshme dhe të armatosura, nuk ishte më shumë se disa mijëra njerëz.

Agjencia Reuters e lajmeve në atë kohë ka raportuar: "Rreth 3000 persona anëtarë të organizatës guerile Moxhahedine Khalk kanë mbyllur rrugët dhe u kanë vë zjarrin disa makinave dhe motoçikletave dhe kanë hedhur slogane kundër shtetit islamik të Iranit".

Përgjegjësia dhe organizimi i protestës ishte detyrë e sektorit shoqëror të kësaj organizate

dhe drejtohej nga Muhamed Zabeti. Përkrahësit e Organizatës Moxhahedine Khalk ishin organizua në grupe 3 deri në pesë persona dhe ishin armatosur me nga një armë të ftohtë. Anëtarët më të lartë të kësaj organizata ishin armatosur me armë zjarri. Thika, shkopinj dhe shumë mjete të tjera si armë të ftohta barteshin nga militantët e kësaj organizate me urdhrin e strukturave të Organizatës Moxhahedine Khalk.

Lajmi i parë i publikuar në lidhje me numrin e viktimave në protestat e datës 19 qershorit 1981 në Teheran, tregonte se mbi 16 qytetarë janë vrarë dhe janë plagosur me dhjetëra të tjerë. Tetë persona të plagosur vdiqën në nesërmen në spital për shkak të plagëve të ashpra që kishin marrë. Zëri i Amerikës në atë kohë protestat e 19 qershorit 1981 në



19 Qershor 1981, fillimi i dhunës së terrorist

Teheran i ka përshkruar si një ngjarje të paparë prej ardhjes në pushtet të sistemit të Republikës Islamike të Iranit dhe deklaroi se gjatë përleshjeve dhe dhunës së asaj dite janë vrarë të paktën 30 persona dhe janë plagosur 200 persona të tjerë.

Prania e grupeve të ndryshme të qytetarëve dhe e forcave të sigurisë në rrugët kryesore dhe qendrore të qytetit, në mënyrë graduale ndryshuan situatën dhe filluan arrestimin e sulmuesve dhe situata në qytet u fut nën kontrollin e forcave të rendit menjëherë pasditen e asaj dite.

Njëkohësisht me këto protesta të dhunshme dhe përleshje në Teheran, edhe në disa qytete të tjera të Iranit si në Esfahan, Hemedan, Orumie, Shiraz, Ahvaz, Arak, Zahedan, Masxhid Siman, Bandar Abas dhe Mashhad

u organizuan protesta të dhunshme dhe përleshje sporadike në përmasa më të vogla gjatë të cilave gjithashtu janë plagosur me dhjetëra persona dhe disa persona janë vrarë. Njëkohësisht me këto ngjarje, Shahpur Bakhtjar, kryeministri i fundit i regjimit mbretëror Pahlavi, në një intervistë me një gazetë franceze deklaroi: "Nëse rrëzohet Beni Sadr, në Iran do të vërshojë gjaku si lumi".

Data 20 qershor 1981, Parlamenti i Iranit pas shumë diskutimeve mes kundërshtarëve dhe përkrahësve, miratoi shkarkimin e Beni Sadr. Ky projektligj u miratua me 177 vota pro, një kundër dhe 12 abstenim.

Më datë 21 qershor të vitit 1981, Imam Khomeini (ra) lëshoi dekretin për shkarkimin e Beni Sadr nga posti i presidentit të Iranit. Që

nga dita e parë e verës së atij viti filluan veprimet terroriste të njëpasnjëshme të Organizatës Moxhahedine Khalk për rrëzimin e sistemit të Republikës Islamike të Iranit. Veprimi i parë terrorist pas 19 qershorit 1981 që u krye nga kjo organizatë ishte ai i datës 26 qershor 1981. Ajetullah Khomeini, lideri suprem i Revolucionit Islamik të Iranit, u bë objekt i një sulmi terrorist që u krye në këtë datë në kohën kur ai ishte në xhaminë Abu Dharr në një prej lagjeve në jug të Teheranit, por arriti t'i shpëtojë këtij sulmi. Më datë 27 qershor 1981, u krye një sulm me anë të një shpërthimi të madh terrorist në zyrën e partisë "Republika Islamike" në Teheran nga pjesëtarët e Organizatës Moxhahedine Khalk ku u martirizuan 72 ndihmës dhe shokë besnikë të Imam Khomeinit (ra) me në krye Ajetullah Beheshti.

Më datë 28 qershor 1981 nga një sulm terrorist u vra Muhamed Kaçui, anëtar i partisë "Republika Islamike".

Më datë 5 korrik 1981, me një sulm terrorist të Organizatës Moxhahedine Khalk, u vra Ali Ansari, kryetari i provincës Gilan të Iranit. Ali Ansari ishte një intelektual i shquar iranian dhe kritikë i ashpër i politikave imperialiste të Amerikës dhe të grupeve pro politikës amerikan.

Më datë 9 korrik 1981, nga një sulm terrorist të Organizatës Moxhahedine Khalk u vra Mola Ali Xhalali sëbashku me të birin i cili ishte një prej klerikëve myslimanë sunitë në provincën Sanandaxh. Ai ishte një aktivist i njohur në rajon dhe kishte dhënë një kontribut të madh për unitetin mes myslimanëve shiitë dhe sunitë, si dha për Revolucionin Islamik.

Më 24 korrik 1981, nga një sulm terrorist të Organizatës Moxhahedine Khalk u vra Khuxhatul-islam Sejed Hasan Beheshtinezhad, deputet i qytetit Esfahan në Parlamentin Islamik të Iranit.

Beni Sadr pasi u shkarkua nga posti i presidentit, filloi të zhvillojë një jetë të fshehur dhe me anë të letrave dhe mesazheve të ndryshme, mendohej të nxisë popullin iranian për rebelim dhe trazira sepse akoma kishte shpresë në përkrahjen e popullit, mirëpo pas zgjedhjeve presidenciale në të cilat Muhamed Ali Raxhai mori 13 milionë vota dhe u zgjodh president i Republikës Islamike të Iranit, më 28 korrik të vitit 1981, u largua i zhgënjyer dhe kokë ulur nga Irani sëbashku me Masud Raxhafi i fshehur nën rroba të grave. Beni Sadr me avionin e kidnapuar nga Irani, sëpari iku në Qipro dhe pastaj shkoi në Francë dhe atje në bashkëpunim me Masud Raxhafi, formoi një organizatë me emrin

"Këshilli i Revolucionit" me qëllim rrëzimin e Revolucionit Islamik të Iranit. Autoritetet e Francës nuk zbatuan kërkesën e autoriteteve iraniane për ekstradimin e Beni Sadr në Teheran.

Më datë 30 korrik 1981, nga një sulm terrorist që u krye nga Organizata Moxhahedine Khalk, u vra Khuxhatul-islam Kamjab, deputet i qytetit Mashhad në Parlamentin Islamik të Iranit.

Më datë 16 gusht të vitit 1981, gjithashtu nga një sulm terrorist që u krye nga Organizata Moxhahedine Khalk, u vra Mola Saleh Khosrovi. Ai ishte një prej klerikëve të myslimanëve sunitë në Iran dhe ka dhënë një kontribut të madh për mbrojtjen e Islamit dhe për unitetin e myslimanëve qysh para fitores së Revolucionit Islamik të Iranit.

Dhe ...

Këto veprime terroriste kanë vazhduar deri më sot dhe si rezultat i tyre janë vrarë 17000 civilë iranianë në mesin e tyre personalitete të shquara shoqërore dhe shtetërore iraniane.

Në numrat e ardhshëm do të vazhdojmë me serialin e veprimeve terroriste të Organizatës Moxhahedine Khalk në Iran.



Një prej anëtarëve femra që është ndarë nga grupi terrorist MEK ka folur mbi ngacmimet seksuale që kreu i këtij grupi terrorist u ka bërë vajzave dhe grave në kampin Ashraf.

Zahra Sadat Mirbageri, një prej lidereve të larguar dhe ndarë nga grupi MEK ka dhënë informacione mbi mënyrën se si Masud Raxhavi ka ngacmuar seksualisht anëtarët femra në kampin Ashraf. Ajo thotë: Raxhavi i ngacmonte dhe shfrytëzonte seksualisht femrat brenda kampit dhe ekziston një listë

veshkave apo mungesës së gjakut. Mirëpo realiteti ishte diçka tjetër pasi këtyre femrave u hiqej mitra me qëllim që pas shfrytëzimit seksual të tyre nga Raxhavi, ato të mos mbesnin shtatzënë. Kjo anëtare e grupit MEK, jep shembuj të tmerrshëm për mënyrën e përdorimit seksual të këtyre femrave nga ana e Masud Raxhavi dhe thotë: Disa prej këtyre vajzave apo femrave të martuara me pretekstin e organizimit të takimeve ideologjike dhe revolucionare...., mbaheshin larg meshkujve apo në takimet e tjera dhe përdorshin vetëm në shërbim të kryetarit të grupit. Këto femra merrnin dhurata nga kreu i MEK, dhurata të cilat ua jepte vetë Marjam Raxhavi. Mirbageri thotë se femrat ishin të detyruara të pranonin shfrytëzimin seksual të tyre nga kreu i grupit

dhe shton; Ne kujtonim se kjo ishte pjesë e ideologjisë së organizatës dhe për këtë nuk kuptonim asgjë. Ne shikonim që femrat e martuara kishin marrëdhënie seksuale me kreun e organizatës dhe përkundër dëshirës tonë ndiqnim veprimet e tyre. Më tutje Mirbageri tha: Masud Raxhavi këtyre vajzave u

me emrat e 100 vajzave dhe grave të cilat janë detyruar tu nënshtrohen operacioneve mjekësore për shkak të përdhunimit të tyre nga ana e Raxhavi. Një prej këtyre operacioneve ishte heqja e mitrës së vajzave dhe grave. Operacioni është kryer pa dijeninë e viktimës që përdhunohej, ndërkohë që femrave viktimat të këtij akti u thuhej se operacioni kryhej për shkak të sëmundjeve të

thoshte se marrëdhëniet seksuale me të ishin më të rëndësishme se edhe namazi i mbrëmjes.

Struktura e ndotur dhe imorale e grupit MEK është një çështje që shumë herë është theksuar nga persona të ndryshme dhe për të janë publikuar shumë fakte dhe dokumente, mirëpo unë si një prej anëtarëve të grupit që kam mundur të ndahem nga grupi dhe të vij në Iran, mund të jap aq shumë shembuj mbi



përdorimin seksual të femrave nga kreu i grupit MEK, saqë emri i këtij grupi mund të futet në librin e rekordeve Guines, pasi një sjellje e tij brenda një grupi apo organizate është e pashoq në botë,- ka thënë Mirbageri. Zahra Sadat Mirbageri e cila për një kohë të gjatë ka qenë anëtare e grupit MEK në kampin Ashraf, në një takim ka publikuar një listë të gjatë me emrat e 100 vajzave dhe grave të cilat u janë nënshtruar operacionit për heqjen e mitrës.

Operacioni për heqjen e mitrës atyre u është bërë brenda kampit Ashraf me qëllimin e vetëm që ato femra të mos kishin mundësi të mbesnin shtatzënë dhe pas kësaj të shfrytëzoheshin si skllave seksi nga Masud Raxhavi. Lind pyetja se si Masud Raxhavi ka shkuar deri aty saqë duke lënë mënjanë principet revolucionare dhe ideologjike të grupit të krijuar prej vetë atij, është marrë me të tilla veprime? Përgjigjja e kësaj pyetjeje është e gjatë. Mirbageri thotë: Ne vazhdimisht ftoheshim për të marrë pjesë në të ashtuquajturat takime ideologjike. Mirëpo këto takime nuk kishin aspak karakter ideologjik pasi ishin takime vetëm për të plotësuar lidhjet seksuale me liderin e grupit d.m.th. Masud Raxhavi i cili personalisht dhe nëpërmjet Marjam Raxhavi u jepte femrave dhurata të ndryshme si parfume. Femrat e nivelit të lartë drejtues, e kishin kaluar këtë fazë të pjesëmarrjes në të ashtuquajturat takime ideologjike dhe kishin rritur në nivelet drejtuese të grupit MEK. Kjo anëtare e grupit MEK ka thënë se femrat detyroheshin të kryenin marrëdhënie seksuale me Masud Raxhavi dhe shton: Ne detyroheshim që të kishim lidhje të veçanta me Masud Raxhavi dhe me atë të flisnim me dashuri. Ne nuk kuptonim se çfarë ndodhte sepse na thonin se lidhja ishte një lidhje ideologjike, edhe pse e kishim shumë të vështirë.

Mirëpo si shembull na tregonin femrat e këshillit revolucionar të grupit MEK të cilat kishin pozita të larta dhe i thërrisnim Motrat e Mëdha. Vazhdimisht tek ne kryhej shpëlarje e trurit për të mos kuptuar asgjë. Mirëpo nëse ne kishim vetëm pak vëmendje

do të kuptonim se përse divorci i detyruar nuk ishte ligj që duhej të zbatohet edhe nga Masud dhe Marjam Raxhavi. Këtë nuk e kuptonim kurrë. Ne më shumë përqendroheshim në temat dhe diskutimet ideologjike. Znj. Mirbageri në një pjesë tjetër të fjalës së saj ka dhënë disa prej metodave të përdorura nga krerët e bazës Ashraf për të detyruar femrat që të kryenin operacionin e heqjes së mitrës. Sa i përket justifikimeve të kreut të MEK rreth përdorimit seksual të femrave, ajo thotë: Kjo listë që shikoni, ashtu siç thashë edhe më sipër, përmban emrat e 95 femrave të grupit MEK të cilat janë mashtruar në forma të ndryshme, siç ishte operacioni për gurin në veshka apo mungesën e gjakut dhe janë detyruar t'i nënshtrohen operacionit për heqjen e mitrës. Një prej komandantëve të lartë të grupit, në formë të habitshme mu vu pas mua për të kryer këtë operacion. Për të bindur femrat që të kryenin këtë operacion ata përdornin metodën e majës së çlirimit. Mirëpo çfarë është maja e çlirimit. Maja e çlirimit ishte pozita që fitonte një grua nëse ajo kryente këtë operacion dhe sipas kreut të grupit çdo grua që kryente operacionin çlirohej nga dëshira seksuale dhe ngrihej lart e më lartë.

Nëse është kështu ashtu përse vetë Masud Raxhavi kryerjen e marrëdhënieve seksuale mes anëtarëve të grupit e cilësonte haram dhe tradhti ndërsa ai vetë në dhomat personale të tij i detyronte femrat që të kryenin marrëdhënie seksuale duke e quajtur këtë veprim të njëjtë si namazi i mbrëmjes. Këto pohime tronditëse lidhur me sjelljet seksuale të krerëve të ndotur të grupit MEK dhe mbi skllavërimin seksual të femrave në kampin Ashraf, bëhen akoma më tronditëse në kohën kur vendet perëndimore dhe evropiane akuzojnë Republikën Islamike të Iranit për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të të drejtave të femrave, ndërkohë që heshtin përballë krimeve të tmerrshme që u janë bërë femrave dhe vajzave në kampin Ashraf. Këto vende jo vetëm që nuk kanë dënuar grupin MEK për të tilla veprime, por këtij grupi i kanë dhënë edhe një shpërblim që është heqja e emrit të grupit MEK nga lista e zezë e grupeve terroriste.

Burimet informative tregojnë se pas

largimit të pjesëtarëve të grupit terrorist Moxhahedine Khalk nga Iraku dhe vendosjen e tyre në Shqipëri, strukturat e Organizatës Moxhahedine Khalk që janë robëruar nga sektu Raxhavi, aktualisht ndodhen në një mjegull organizative-politike-ideologjike dhe po përballen me shembje të brendshme.

Sipas burimeve informative të përditshme që flasin nga brenda forcave kritike në Shqipëri, sektu Raxhavi ndodhet në një mjegull të thellë organizative dhe shkatërrimi është faktori më i madh që e kërcënon jashtëzakonisht këtë sekt. Prandaj Marjam Raxhavi ka dhënë urdhër që të organizohen mbledhje të vazhdueshme dhe sistematike që kanë natyrë arsyetuese në kuadër të rindërtimit të mendimeve dhe ideve të pjesëtarëve të këtij grupi në Shqipëri.

Problemi qëndron këtu se forcat që janë vendosur në Shqipëri, kanë filluar të shtrojnë pyetje të tilla si:

- Çfarë u bë me detyrën e "Ushtrisë Çlirimtare"?
- Si do të bëhet rrëzimi i pushtetit?
- Duke marrë parasysh mungesën e pranisë fizike afër kufijve të Iranit, si do të realizohen qëllimet e ushtrisë së ashtuquajtur "çlirimtare"?
- Çfarë është gjendja jonë në Shqipëri dhe deri kur do të qëndrojmë në këtë vend?
- Çfarë ndodhi me premtimet boshe të Raxhavi se Liberti është urë drejt Teheranit?
- Çfarë ishte rezultati i gjithë atyre vrasjeve dhe torturave që përjetuam në Irak?
- Çfarë ndodhi me moton "Moxhahedi vdes, por nuk i jep bazën ushtarake Ashraf armikut" ose "Mbrotjtja e Ashraf është e barabartë me çlirimin tre herë të Teheranit"?




Marjam Raxhavi për tu përballur me çështjen e paraqitjes së pyetjeve të tilla brenda Organizatës, ka dërguar disa pjesëtarë të sektit Raxhavi në Shqipëri për të mbajtur mbledhje arsyetuese sistematike dhe duke reduktuar presionin organizativ, të parandalojë shkatërrimin e padyshimtë të Organizatës. Prandaj, personat e dërguar në Shqipëri, përkundër të kaluarës, kanë hequr dorë nga të gjitha kufizimet e kaluara dhe kanë ndryshuar terminologjinë e brendshme të marrëdhënieve që buronte nga revolucioni ideologjike me qëllim që të reduktohet zemërimi dhe hidhërimi i pjesëtarëve të këtij grupi terrorist. Për shembull, në vend të ritualit

"Zero
Zero
Ditore"
(që ishte shkrimi në letër i veprimeve dhe mendimeve të tyre gjatë ditës), kërkohet nga pjesëtarët që të rrëfejnë kujtimet e tyre

ditore dhe personat drejtues të këtyre mbledhjeve janë urdhëruar që në vend të kritikave të ashpra ndaj pjesëtarëve, të paraqesin vetëm problemet dhe t'i tejkalojnë çështjet e tjera duke u munduar të shtojnë ndjenjat mes tyre. Të gjitha përpjekjet e sektit Raxhavi përqendrohen në këtë çështje se si përsëri të mashtrojë pjesëtarët e tij në mënyrë që ata të harrojnë premtimin e rrëzimit të regjimit me "ushtrinë çlirimtare" dhe në vend të këtij premtimi të përkushtohen në të ardhmen. Krerët e kësaj Organizate u thonë pjesëtarëve të saj: "Ne në Irak nuk kishim siguri dhe për çdo ditë përballëshim me bomba dhe raketa. Tani kemi gjetur rastin për sulm politik dhe duhet

të hartojmë një kapitull të ri për aktivitet në Shqipëri". Marjam Raxhavi këtë çështje e shpjegon në këtë mënyrë: "Me sulme politike nga Shqipëria padyshim do të përgatiten rrethanat për rrëzimin e regjimit në Iran dhe do të formohet një kryengritje popullore. Për shembull, ne kemi mundësi që duke paraqitur çështjen e drejtësisë në lidhje me ekzekutimet e vitit 1988 dhe duke u përkushtuar në çështjen e të drejtave të njeriut kundër Iranit, t'i hedhim një gotë tjetër helm në gojën e regjimit!"

Kaluan disa muaj nga koha kur princi saudit Turki Fejsal shpalli vdekjen e Masud Raxhavi. Ajo që dihet me siguri, është fakti



se
Marjam
Raxhavi
për
shkak të
paaftësis
ë dhe
eksperie
ncës jo
të duhur,
nuk
respekto
het me
seriozite
t nga
pjesëtarë
t e
Organiz
atës
Moxhah

edine Khalk. Marjam Raxhavi për shkak të kësaj dobësie ose nuk mund të pranojë dhe pohojë vdekjen e Masud Raxhavi ose nuk mund ta zbulojë vendin e fshehjes së Masud Raxhavi duke dokumentuar se ai është gjallë.

Në të dy gjendjet, një realitet është i pamohuar se në vështrimin e pjesëtarëve të grupit terrorist Monafekin, Marjam Raxhavi nuk ka meritat dhe aftësitë e mjaftueshme për udhëheqjen e Organizatës Moxhahedine Khalk.

Kjo është një çështje që ka shtuar edhe më tepër problemet e sektit terrorist Raxhavi në Shqipëri.

Ali Xhahani ekspert i çështjeve të grupit terrorist Monafekin (MEK) shkruan: Organizata Muxhahedin-e-Khalk (MEK), e cila në një kohë është themeluar nga themeluesit e saj dhe që më pas nga Raxhavi u kthye në një grup terrorist dhe bandë të rrezikshme mafioze,

tani ndodhet në kushte tepër të rënda dhe të këqija dhe për këtë grup nuk mund të parashikohet asnjë e ardhme e qartë dhe për këtë do të paraqesim disa parametra që janë të nevojshëm për të përcaktuar fatin e së ardhmes.

1- Kryesia e Masud Raxhavi:

Masud Raxhavi i cili duke tradhtuar themeluesit e organizatës përjetësisht mori kryesinë e këtij grupi, për shkak të karakteristikave dhe dhuntisë së tij drejtuese, ndoqi stilin e Stalinit me qëllim që mendimet e veta tua impononte anëtarëve të organizatës dhe në këtë formë përherë të qëndronte në krye të organizatës. Raxhavi ambientin shtypës brenda organizatës e krijoi me ndihmën e Sadamit. Mirëpo pas rrëzimit të Sadamit ai nuk mund ta mbante gjallë këtë ambient dhe u detyrua të fshihet. Tani kur ka kaluar pothuajse një dekadë nga fshehja e tij, kanë dalë pëshpërimita se ai ka vdekur. Pëshpërimitat për vdekjen e tij janë bërë akoma më të besueshme pasi ai për shumë vite nuk ka dhënë mesazhe dhe nuk ka dhënë mesazh as

pas largimit të organizatës nga Iraku. Në këtë mënyrë mund të thuhet se kulti Raxhavi ka mbetur pa kryetar dhe duke qenë se kryetari Raxhavi ishte një person i veçantë dhe pa të kulti nuk mund të vazhdojë jetën e vet, mund të thuhet se për këtë kult nuk ka ndonjë të ardhme të qartë. Pikërisht për këtë arsye kryetarja aktuale e kultit d.m.th. Marjam Raxhavi e ka mbajtur të fshehtë vdekjen e Masud Raxhavi dhe nuk është prononcuar aspak për këtë çështje. Ajo e di mirë se nëse konfirmon vdekjen e Masud Raxhavi, atëherë ajo vulos shkatërrimin e grupit dhe e përshpejton fundin e MEK. Për momentin, kulti Raxhavi është një kult pa kreun Raxhavi.

2- Largimi nga Iraku

Një parametër i rëndësishëm është se Raxhavi duke shkuar në Irak dhe duke insistuar në strategjinë e tij të luftës kundër Iranit dhe Irakut, ashtu siç thoshte edhe vete donte të realizonte projektin e rrëzimit. Tani kur humbi mbështetjen e gjithanshme të Sadam Huseinit, mbeti pa armë, humbi bazën strategjike Ashraf dhe së fundmi me largimin nga Iraku dhe vendosjen në vendstrehimin e refugjatëve në Tiranë, organizata është kthyer në një formacion i vdekur, që nuk mund të bëjë asgjë, pa të ardhme dhe një organizatë që shumë shpejt do të zhduket plotësisht.

3- Gjendja e të ashtuquajturës " Ushtria Çlirimtare "

Raxhavi kur shkoi në Irak, krijoi të ashtuquajturën Ushtria Çlirimtare. Kjo ushtri e vogël ishte në shërbim të Sadamit dhe misioni kryesor ishte kryerja e operacionit për rrëzimin e shtetit në Iran, vrasja e ushtarëve të

çlirimtare, ka humbur armët, bazën strategjike Ashraf dhe duke dalë jashtë Irakut është kthyer në një luan pa kurorë, i lodhur dhe i dërrmuar. Shumica e pjesëtarëve të kësaj ushtrie janë të moshuar dhe të sëmurë të cilët



pafajshëm në kufi, bombardimi i zonave të banuara, kryerja e sulmeve ndaj rajoneve jo ushtarake dhe vrasja e njerëzve të pafajshëm. Misioni i kësaj ushtrie në Irak, ishte zbatimi i operacionit Marvarid, vrasja e kurdëve, shtypja e shiitëve në jug të Irakut dhe të gjitha këto veprime vetëm e vetëm për të mbrojtur dhe shpëtuar Sadamin dhe për ta mbajtur atë në pushtet. Raxhavi gjithmonë në takimet dhe asambltetë e ndryshme paraqitej i veshur me rroba ushtarake me një pistoletë dhe me një shpatë. Ai kishte krijuar këtë të ashtuquajturën Ushtria Çlirimtare që në fakt ishte një kult terrorist i kryesuar prej tij dhe që kishte për qëllim vetëm rrëzimin e shtetit, kult që ai e quante të vetmen alternativë pasi të tjerët i quante tradhtarë të cilët i kërcënonte me vdekje. Tani kjo ushtri e ashtuquajtur

duke u vendosur në qendrën e strehimit të refugjatë në Tiranë, këtë qendër e kanë kthyer në azil për të moshuarit që nuk kanë asnjë funksion. Kulti Raxhavi me revolucionin e sajuar të Marjam Raxhavi nuk mund të mbajë gjallë këtë ushtrisë dhe ky revolucion i sajuar më nuk ka asnjë efekt për të shpëlarë trurin e forcave të humbura.

4- Gjendja strategjike e kultit

Kulti Raxhavi duke u mbështetur në strategjinë e dhunës dhe terrorit dhe në ideologjinë e luftës së armatosur dhe rezistente, si objektiv kryesor të strategjisë kishte rrëzimin(e shtetit). Mirëpo pas vendosjes së armëpushimit në luftën mes Iranit dhe Irakut dhe pas zbulimit të pretendimeve boshe të Raxhavi se Irani kurrë nuk pranon

paqen dhe armëpushimin dhe pas veprimt të nxituar të Raxhavi i cili dërgoi forcat e organizatës në luftë me Iranin, forca që për shkak të mungesës së eksperiencës dhe gatishmërisë ushtarake pësuan humbje të thellë, u bë e qartë se strategjia e kultit Raxhavi ishte një strategji e dështuar dhe jo efikase. Në këtë mënyrë strategjia e Raxhavi mbeti u bllokua në baltë dhe nuk lëvizi. Mirëpo Raxhavi për tu dhënë kurajë forcave të kultit dhe për të mbajtur gjallë organizatën, gjithmonë pretendonte se armëpushimi nuk është i qëndrueshëm dhe se regjimi i Iranit kurrë nuk pranon paqen e qëndrueshme dhe për këtë lufta do të rinisë dhe pasi të nisë lufta ushtria çlirimtare do të nisë operacionin Farugh-2. Kur në krye të Iranit u zgjodh presidenti Khatami, kulti thoshte se kjo zgjedhje për Iranin është si kupa me helm dhe se Khatami nuk do të zgjidhet në raundin e dytë pasi kulti do ta rrëzojë regjimin e Iranit. Përveç kësaj kulti për të mbajtur gjallë frymëzimin e ushtrisë së ashtuquajtur çlirimtare, ndërmoi edhe disa veprime të tjera si periudha trajnuese 77-A, Sin A, periudha trajnuese 6 mujore Sin, disa manovra ushtarake, divorcet e obliguara, si dhe organizimi i disa takimeve për shpëlarjen e trurit të anëtarëve. Me të tilla veprimi Raxhavi donte të tregonte se strategjia nuk kishte vdekur dhe kishte ruajtur efikasitetin e saj. Mirëpo më vonë kjo strategji me rrëzimin e Sadamit dhe çarmatosjen e organizatës, u eliminua një herë e përgjithshme dhe të gjithë

anëtarët e organizatës e kuptuan se strategjia e luftës dhe rezistencës së armatosur është strategji e dështuar dhe pa asnjë efikasitet. Edhe pse organizata nuk ka pranuar dështimin e kësaj strategjie, mirëpo kjo strategji tashmë nuk funksionon më. Tani duhet parë se cili është fati i organizatës MEK brenda kampit në Tiranë, pa kryetarin Masud Raxhavi, jashtë territoreve të Irakut dhe me një ushtri të paarmatosur, të dalë jashtë funksionit dhe me një strategji të dështuar. Edhe pse organizata ka mundur të arratisë dhe shpëtojë kërret e saj kriminalë dhe strukturën e saj ta transferojë në formë unike, duke e cilësuar këtë fitore për veten e saj, tashmë ajo po mundohet që të arrijë qëllimin dhe objektivin e vet të rrëzimit të shtetit në Iran, duke marrë ndihmë nga Izraeli dhe nga sheikët e Arabisë Saudite. Mirëpo tashmë kjo organizatë është e rrëpur dhe trupi i saj i kalbur nuk ka asnjë funksion dhe shumë shpejt do të shkatërrohet përfundimisht.



Parstoday është një sajt informativ iranian, i cili duke shfrytëzuar përvojën mbi 70 vjeçare të Shërbimit të Jashtëm të RTV të Iranit (IRIB Worldservice), ka filluar në një formë të re mediatike aktivitetin e tij në Janar 2016, duke transmetuar në mbi 30 gjuhë të botës lajme dhe informacione mbi zhvillimet kryesore në rajon dhe të botë.

Parstoday posedon shërbime mediatike si website, radio, transmetim përmes valëve në frekuenca, në internet dhe në celular si dhe në rrjetet sociale. Parstoday i transmeton informacionet për publikun në gjuhët shqip, arabisht, armene, bengale, kineze, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, husa, hebreje, indiane, indoneziane, italisht, japoneze, kazake, savahili , pashtun, portugalisht, rusisht, spanjisht dhe turqisht dhe numri i redaksive në gjuhë të huaja do të shtohet.

Zhvillimet politike në Lindjen e Mesme dhe roli i rëndësishëm i Iranit si një vend ndikues në rajon dhe si një vend i sigurt dhe në zhvillim, e shton edhe më shumë rëndësinë e Parstoday si një media me ndikim.

Parstoday në gjuhën shqipe ofron për publikun programe dhe emisione me tematika informative, politike, kulturore dhe fetare duke informuar opinionin me të pathënat e mediave botërore.

Programe të Parstoday në gjuhën shqipe ofrohen për miliona shqiptarë në rajonin e Ballkanit dhe në rajone të ndryshme të botës, të cilët janë të interesuar të njihen realisht me zhvillimet në Iran, në lindjen e Mesme dhe në vendet banuara nga popullsia shqiptare.

Për informacione të mëtejshme, kontaktoni me ne.

Parstoday.com/sq



albanian@parstoday.com

Tel: +98-21-22162833

Tel: +98-21-22162716

Celular: +98-903-5065501



facebook.com/ParsTodayAlbanian



instagram.com/parstodayalbanian



[@ParsTodaySq](https://twitter.com/ParsTodaySq)